


Thesare në Ramazan



بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

*Ju urojmë agjërim të lehtë
dhe të pranuar tek Allahu!*



Përgatiti: Noka & Ibra

*Tirazhi: 5000
Botimi i dytë
Duisburg 2017*

Mesazhi i Ramazanit

Ramazani po afron, prapë po na vjen ky muaj i shenjtë. Sa shpejt që kaloi edhe një vit! Më kujtohet shumë mirë Ramazani i vitit të kaluar, sikur të ishte dje. Dhe se sa shpejt kaloi ai... Dhe ja, jeta po vazhdon dhe koha ecën me shpejtësi skëterrë, si një lokomotive e cila na tërheq nga mbrapa. Nuk na pyet nëse duam të ecim me të apo jo, por ajo vazhdon rrugën e saj.

A nuk ju duket edhe juve që koha po ecën shumë shpejt?!!

Nuk e di a po ecën koha shpejt, apo po ecim ne ngadalë saqë nuk e arrijmë atë... A nuk ishte shumë afër koha kur miku ynë i nderuar, Ramazani na vizitonte neve në dimër?!!!

Ja tani po vjen të na vizitojë edhe në verë, të na sprovtojë pak më shumë me gjatësinë dhe nxehtësinë e ditës.

Ramazani, ky muaj i begatë na viziton njëherë në vit, duke na ardhur në pranverë, verë, vjeshtë dhe dimër. Ky muaj me vlerë na jep mundësi për meditim, t'i themi jetës tonë : Ndal o jetë se na hutove me kënaqësitë e kësaj bote kalimtare!!! Ndal se na more frymën duke shpejtur pas gjërave pa vlerë!!! Ndal sa të ushqej shpirtin me besim, adhurim, devotshmëri!!

Ndal se unë dua të dëgjoj thirrjen e Zotit tim i Cili më fton në shpëtim, në mëshirë, në kopshtet e bukura të Xhennetit!

Ramazani po i vjen në ndihmë shpirtit i cili është lodhur duke mbajtur trupin e rëndë... Në këtë muaj le të lodhet pak trupi dhe le të pushojë shumë shpirti... Ramazani, ky muaj që Allahu i ka dhënë më shumë vlerë se muajt e tjerë, të cilin e ka përmendur me emër në Librin e Tij të shenjtë, në të është mundësia më e mirë për atë që dëshiron të ndyshojë vetveten, për atë që do të shpëtojë shpirtin e tij.

Ramazani, kohë për meditim, të pendohemi për jetën që kaluam pas kënaqësive të kësaj bote dhe të drejtojmë idealet tona në botën e ardhme të përjetshme.

Ramazani, kjo derë e mëshirës që mundëson që era e parfumit të besimit të depërtojë në zemrat tona!

Ramazani, koha e tregtisë me të vlefshme për besimtarin që t'i shumojë pemët e kopshtit të tij në xhennet.

Ramazani, koha e vetllogarisë për secilin nga ne.

Kjo mirësi e madhe që po afron, mendoni se sa shumë njerëz nuk kanë mundësi ta përjetojnë më, mendoni sa na do Allahu që po na e jep këtë dhuratë kaq të madhe!

Ramazani, muaji i Kuranit, muaji i ibadeteve, i Teravive, muaji i duave dhe i lotëve! Le të rrjedhin lotët tona si lumë në të cilin pastrohet shpirti ynë nga gjynahet!

Ramazani, muaji i bashkimit të muslimanëve me shumë se kurrë, muaji i iftareve të përbashkët, muaji në të cilin muslimanët takohen cdo ditë në xhami për të falur namazin e Teravisë!

Ramazani, në të cilin njerëzit janë me afër Allahut, më afër vetvetes dhe më afër njerëzve të tjerë. Në këtë muaj besimtari e edukon veten e tij në përruljen ndaj Allahut, e mund nefsën e tij duke ia mohuar brenda ditës nevojat më elementare për jetën, ngrënien dhe pirjen! Dhe në iftar gezimi i paparë për arritjen e suksesit, që ia dolëm mbanë këtij qëllimit tonë dhe kështu bëmë një hap drejt kënaqësisë së Allahut! Agjërimi në këtë muaj, ama agjërimi i çdo pjese të trupit, jo vetëm i stomakut, por edhe i gjuhës, edhe i veshëve, syve, këmbëve dhe duarve, edhe agjërimi i zemrës, ky lloj agjërimi pra e ka shpërblimin vetëm nga Allahu, shpërblim pa hesap, sa askush tjetër nuk e di. Ky agjërim na bën të kuptojmë më mirë të varfërit, të vobektët, jetimët anëmbanë botës, të cilët kushedi se sa kohë qëndrojnë pa ngrënë dhe pirë. Me këtë agjërim Allahu na jep shansin që të jemi më afër atyre, që të përjetojmë edhe ne vetë ndjenjat e tyre, që të na shtohet keqardhja për ta, humaniteti, solidariteti, ndihma si nga ana materiale, ashtu edhe nga ana

shpirtërore me dua dhe lutje për ta. Se varfëria është një sprovë e vështirë të cilën Muhammedi a.s. e ka krahasuar me kufrin.

Agjërimi na afron gjithashtu edhe më shumë me veten tone, ti lemë mënjanë të gjitha ato gjëra që na e mpijnë trurin dhe na e prishin zemrën, si TV, Computer, telefonin, duhanin e lojërat e ndyshme që na vjedhin kohën. Të kalojmë kohë intensivisht me veten tonë, me Krijuesin tonë. Të vemë qëllime për jetën tonë, të kuptojmë nga thellësia e zemrës shkakun e krijimit tonë, t'i kthellojmë idealet në mendjen tonë.

Të mirat e Ramazanit nuk mbarojnë me të numëruar. Agjërimi ka edhe shumë të mira mjekësore, edhe pse jomuslimanët na e përmendin shpesh se si mundemi të qëndrojmë kaq gjatë pa ujë. Ama Allahu i cili na ka krijuar neve, e di më mirë se çdokush se cfarë është e mirë dhe cfarë është e keqe për ne. Allahu ka krijuar sëmundjen dhe ilaçin. Dhe mjeku më i mirë është për ne Krijuesi ynë. Allahu nuk do kurrë të keqen për ne, as vështirësinë. Sa e sa sëmundje i kurojnë mjekët sot me dieta të ndryshme, në të cilat lejohet të konsumosh vetëm gjëra të posaçme dhe në kohë të veçanta. A keni menduar ndonjëherë për stomakun? I shkreti se cfarë heq nga ne. Vazhdimisht e fusim në punë dhe e lodhim. E lëmë të pushojë vetëm natën kur

flemë. Pra agjërimi i jep stomakut mundësi të pushojë, pas një viti i cili punon thujse pa pushim.

Ama kujdes edhe në kohën e iftarit! Mos të hamë në iftar atë që do të kishim ngrënë në mëngjes, drekë dhe darkë. Nuk është ky kuptimi i agjërimit. Muhammedi a.s. na ka këshilluar që kur të hamë, ta mbushim 1/3 e stomakut me ushqim, 1/3 me ujë dhe 1/3 ta lëmë për frymëmarrje. Mos ta mbushim të gjithë stomakun me ushqim dhe ujë, derisa të mos marrim dot më frymë.

Edhe Allahu na këshillon në Kuran duke na thënë:

„Hani e pini por mos e teproni...” Sure Araf / 31

Pra, për atë që ka dashur të bëjë dietë gjatë vitit, le ta bëjë atë në Ramazan. Me këtë të ketë edhe shpërblimin e agjërimit, edhe efektin e dietës inshaAllah.

Të gjitha keto të mira e kemi më të lehtë t'i arrijmë me mirësinë e Allahut i Cili në këtë muaj i hapi për ne dyert e Xhennetit, i mbylli dyert e Xhehennemit dhe Iblisin e lidhi me zinxhirë.

Shejtani, ky armik i muslimanit, lëviz në enët tona të gjakut, pra shëtit të gjithë trupin tonë. Sa më shumë gjak në trup, aq më i fortë është shejtani. Sa më të gjëra enët e gjakut, aq më rehat lëviz shejtani në to. Kur agjërojmë dhe e kufizojmë ushqimin dhe pirjen, enët e gjakut automatikisht ngushtohen. Dhe në këtë mënyrë ia kemi vështirësuar lëvizjen shejtanit. Pra kjo

është një shenjë që po fitojmë luftën me shejtanin. Shikoni se çfarë ndihme e madhe për ne qenka agjërimi!!!

Nuk ka thënë më kot Muhammedi a.s., dhe ne e dimë se Ai nuk flet nga mendja e vet, por vetëm atë që ia mëson atij Allahu, i cili na ka mësuar: “O ju të rinj! Martohuni! Kush nuk ka mundësi të martohet, le të agjërojë!” Çfarë lidhje ka agjërimi me martesën? Ai që nuk ka mundësi të martohet, ekziston mundësia që të bëjë haram me femra ose meshkuj të tjerë. Dhe kjo padyshim që është një punë që e nxit shumë shejtani i mallkuar. Dhe mënyra për t`ia ngushtuar rrugët shejtanit, e thamë që është agjërimi. Sa i madh është Allahu, i Cili për çdo sfidë që kemi në jetë, na ka mësuar edhe mënyrën se si ta tejkalojmë atë me sukses!!!

Muaji i Ramazanit është afër, disa e presin me përlulje dhe përkushtim, disa me tallje dhe argëtim. Shumë njerëz harrojnë që ky është muaji i Provimit, provim i durimit, qëndrueshmërisë, vullnetit, sinqeritetit! Ramazani është muaji i mëshirës, faljes, furnizimit, mirësive, por në të njëjtën kohë është edhe muaji i sakrificës, i vetëmohimit. Duhet shumë punë, angazhim, përpjekje. Shumë lëvizje, djersë, etje, uri. Të arrihet kulmi i durimit. Kulmi i lodhjes. Kulmi i rezistencës. Derisa qenia jonë të edukohet.

Ka njerëz që futen në këtë muaj, dhe arrijnë kënaqësinë e Allahut, por ka edhe të tjerë, Zot na ruaj, që pa vetëdije tërheqin mbas vetes hidhërimin e Tij! Në këtë muaj shumë njerëz agjërojnë, por nuk ju mbetet nga agjërimi i tyre vetëm se uria dhe etja. Ju humbasin të gjitha shpërblimet, për shkak se ju agjëron vetëm stomaku!

Ka të tjerë që fitojnë të mira shpirtërore, por pasi pastrohen nga gjynahet, shpejt e humbasin pastërtinë! Pastërtia mund të arrihet shpejt, por më e vështirë dhe më e rëndësishme është ruajtja e saj. Dhe agjërimi ia mëson njeriut këtë gjë, të qëndrojë i fortë dhe i paluhatshëm në përballje me të papastrën, me gjynahun.

Le të jetë ky muaj që të arrijmë pastërtinë dhe ta ruajmë atë, të kujtojmë besën e dhënë Allahut dhe ta ruajmë atë. Le të jetë një shkollë për ne ku të edukojmë veten tonë, të bojkotojmë të keqen që na vjen nga nefsi dhe nga shejtani.

Le të jetë ky Ramazan një mjet që na udhëzon drejt Lumturisë së Përherëshme, drejt Kënaqësisë së Krijuesit tonë! Amin.

Dita 1

Ajet Kuranor: „O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.“ (El-Bekare 183)

Hadith profetik: “Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij, përveç agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të.”

Duaja e ditës: O Allah! Në këtë ditë më afro tek kënaqësia Jote, më mbaj larg zemërimit dhe dënimit Tënd, më jep rastin t’i recitoj ajetet e Tua, në mëshirën Tënde, o më i Mëshirshmi i mëshiruesve! O Allah na i hap dyert e Mëshirës Tënde! O Allah na zbut sytë me lotë të besimit! O Allah na zbut zemrat tona me ëmbëlsinë e imanit! O Allah sa afër të kam, dua të të flas me gjuhën e sinqeritetit, me fytyrën e shndritur dhe me shpirt të dorëzuar ndaj Teje!

Thënje e urtë: Kërkimi i së mirës është i vështirë, ndërsa lënia e së keqes është më e vështirë, sepse çdo të mirë nuk ke nevojë ta marrësh, kurse çdo të keqe duhet ta lësh.

Loti nuk sjell dhimbje, por dhimbja sjell lot, mos thuaj o Zot kam një dhimbje, por o dhimbje kam një Zot!

Dita 2

Ajet Kuranor:“ Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (agjërimi), janë të obliguar për kompensim, ushqim (ditor), i një të varfëri, ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për të. Mirëpo, po qe se e dini, agjërimi është më i mirë për ju.” (El-Bekare 184)

Hadith profetik: “Kush e agjëron muajin e Ramazanit duke besuar fuqishëm dhe duke e dëshiruar shpërblimin e Allahut dhe kënaqësinë e Tij, do t’i falen mëkatet e mëhershme.” (Buhariu: 38).

Duaja e ditës: O Allah! Në këtë ditë bëje agjërimin tim si agjërimin e të sinqertëve, dhe qëndrimin tim në namaz, prej qëndrimit të atyre që falen me bindje, zgjomë në të nga gjumi i të pavëmendshmit, e m’i shlyej mëkatet, o Zot i botës, dhe më fal mua, o Falësi mëkateve! O Allah na mëso ato të mira që ia ke mësuar të zgjedhurit Tënd, Muhamedit a.s., na bëj për të tjerët pishtar ndriçues e për veten oqean të veprave të mira!

Thënje e urtë: Njeriun e bëjnë njeri 4 gjëra: Drejtësia, dituria, durimi dhe kursimi.

Dita 3

Ajet Kuranor: „Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju...” (El-Bekare 185)

Hadith profetik: “Agjërimi ndërmjetëson për robin në Ditën e Gjykimit dhe thotë: O Zot, ai është privuar prej ushqimit dhe kënaqësive gjatë ditës andaj unë ndërmjetësoj për të.”

Duaja e ditës: O Zot! Nëse më jep pasuri, mos ma merr lumturinë, e nëse më jep fuqi, mos ma merr mendjen! O Zot, kur të më dhurosh sukses, mos ma merr modestinë time, e kur të më dhurosh modesti, mos ma merr krenarinë me karakterin tim! Zoti im! Si të zhgënjehem, kur Ti je shpresa ime! E si të nëpërkëmbem, kur në Ty jam mbështetur.

Thënje e urtë: Bëhu ambicioz i diturisë, falës fisnik i shoqërisë, rob falënderues i Perëndisë, i dëgjueshëm në kohë të pleqërisë.

Dita 4

Ajet Kuranor: „E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua.“ (El-Bekare 186)

Hadith profetik:“ Agjërimi është mburojë (nga epshet dhe zjarri), prandaj kur të agjërojë ndokush le të mos flasë fjalë të ndyta dhe mos ta ngre zërin, e nëse dikush e ngacmon apo e sulmon, le të thotë: Unë jam agjërueshëm, unë jam agjërueshëm!”.

Duaja e ditës: O Allah! Në këtë ditë, më dhuro urtësi dhe vetëdije, më mbaj larg cektësisë dhe krekosjes, më jep pjesë në çdo bekim që zbret, me bujarinë Tënde, o më Bujari i bujarëve!

Thënje e urtë: Dijetarët në të kaluarën e këshillonin njëri-tjetrin më këto fjalë:

- Kush e përmirëson të fshehtën e tij, Allahu ja përmirëson të dukshmen e tij,
- Kush e përmirëson relacionin e tij me Allahun, Allahu ja përmirëson relacionin e tij me njerëzit, dhe
- Kush punon për ahiretin e tij, Allahu ja përmirëson dunjan e tij."

Dita 5

Ajet Kuranor: „Natën e agjërimit u është lejuar afrimi te gratë tuaja, ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato. All-llahu e di se ju e keni mashtruar vetveten, andaj ua pranoi pendimin tuaj dhe ua fali gabimin. Tash e tutje bashkohuni me to dhe kërkoni atë që ua ka caktuar All-llahu dhe hani e pini derisa qartë të dallohet peri i bardhë nga peri i zi në agim, e pastaj agjërimit plotësojeni deri në mbrëmje. E kur jeni të izoluar (në i'tikafë) në xhami, mos t'u afroheni atyre (për marrëdhënie intime). Këto janë dispozitat e All-llahut, pra mos i kundërshtoni. ..” (El-Bekare 187)

Hadith profetik: “Kur të hyjë Muaji i Ramazanit, hapen dyert e Xhenetit, mbyllen dyert e Xhehenemit dhe lidhen në pranga shejtanët.”

Duaja e ditës: "Zoti ynë! Mos na i lako zemrat tona pasi na drejtove, na dhuro mëshirën Tënde, sepse vetëm Ti je dhuruesi i madh!".

Thënje e urtë: “Le të ketë secili prej jush zemrën e cila falënderon, gjuhën që e përmend Allahun dhe një grua besimtare e cila i ndihmon atij me veprat e saja për jetën tjetër (Ahiretin)”.

Dita 6

Ajet Kuranor: “Ndhmoni njëri-tjetrin në mirësi e devotshmëri dhe mos ndihmoni njëri-tjetrin në gjynah e armiqësi. Dhe kini frikë Allahun, se pa dyshim Ai është i ashpër në ndëshkim.” (Maide, 2)

Hadith profetik: “Dhe, pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti i Muahmmedit, aroma e pakëndshme që del nga goja e agjëruesit është më e mirë tek All-llahu se sa era e miskut. Agjëruesi i përjeton dy gëzime: kur të hajë iftar gëzohet dhe kur ta takojë Zotin e vet gëzohet për agjërimin e vet (për shpërblimin)”.

Duaja e ditës: O Zoti im! Më jep shëndet në trupin tim, O Zoti im, më jep shëndet në të dëgjuarit tim, O Zoti im, më jep shëndet në të pamurit tim. S'ka të adhuruar tjetër përveç Teje. O Zoti im, kërkoj mbrojtjen Tënde nga kufri (mosbesimi) e varfëria dhe kërkoj mbrojtjen Tënde nga dënimi i varrit. S'ka të adhuruar tjetër përveç Teje!

Thënje e urtë: „Nuk qëndron dashuria e kësaj bote dhe dashuria e Ahiretit në zemrën e një besimtari, sikurse nuk mund të qëndrojë uji dhe zjarri në një enë të vetme”.

Dita 7

Ajet Kuranor: "Thuaj: "O robërit e Mi, të cilët e keni ngarkuar me shumë gabime veten tuaj, mos e humbni shpresën ndaj mëshirës së All-llahut, pse vërtetë All-llahu i falë të gjitha mëkatet, Ai është që shumë falë dhe është mëshirues!" (Zumer:53)

Hadith profetik: "Vërtet, në xhenet është një derë e cila quhet ER-REJAN, hynë në të agjëruesit dhe nuk hyn në të askush tjetër përpos tyre. E kur të mbaron hyrja e tyre, mbyllet ajo derë dhe nuk hyn askush tjetër."

Duaja e ditës: O Mbikëqyrës i çdo gjëje, me mëshirën Tënde kërkoj ndihmë, ma përmirëso tërë gjendjen time dhe mos më lë të mbështetem në veten time, as sa një lëvizje e syrit! O Allah në këtë ditë më forco në zbatimin e urdhrave të Tua, ma mundëso shijimin e ëmbëlsisë së dhikrit Tënd, ma mundëso me mirësinë Tënde që të të falenderoj pandërprerë!

Thënje e urtë: Cilësitë e muslimanit bashkëkohor: I shëndoshë në besim, i rregullt në adhurim, solid në moral, me kulturë të gjërë, i fortë në trup, i aftë për të fituar, kërkues ndaj vetvetes, i kujdesshëm ndaj kohës, i organizuar në punë dhe i dobishëm për të tjerët.

Dita 8

Ajet Kuranor: “Ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtare, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t’u thuhet):“Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!” (El Hadid 12)

Hadith profetik: “Me të vërtetë Allahu nuk shikon trupat dhe as fizionominë tuaj. Në të vërtetë Ai shikon zemrat dhe punët e juaja.”

Duaja e ditës: O Zoti im! Më bëj që të më mjaftojë hallalli Yt dhe të mos i afrohem haramit dhe më bëj të pasur me mirësitë Tua që të mos kërkoj prej tjetërkujt përveç prej Teje! O Allah në këtë ditë, më ndihmo me agjërimin dhe namazet e saj dhe më mbaj larg nga gabimet dhe mëkatet e saj, ma mundëso të Të kujtoj pareshtur gjatë saj!

Thënje e urtë: Besimi në Zot është: Forca e moralit dhe morali i forcës, shpirti i jetës dhe jeta e shpirtit, sekretet e botës dhe bota e sekreteve, bukuria e dunjasë dhe dunjaja e bukurive, drita e rrugës dhe rruga e dritës.

Dita 9

Ajet Kuranor: „O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt padashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.“
(Huxhurat 6)

Hadith profetik: “Me të vërtetë, sinqeriteti të shpie tek mirësia, e mirësia të shpie në Xhenet. Vërtet, njeriu vazhdon të jetë i sinqertë (në fjalë e vepra) derisa shkruhet tek Allahu i Sinqertë. Kurse, me të vërtetë, gënjeshtria të shpie drejt shturrjes, e shturrja të shpie në Zjarr. Vërtet, njeriu vazhdon të gënjejë derisa shkruhet tek Allahu gënjeshtar.”

Duaja e ditës: O Allah! Të lutëm më fal mua për gjithë të këqijat, që kam bërë dhe vazhdoj të bëj. Ti je kaq i mëshirshëm dhe i butë. Të lutem më fal mua dhe më ndihmo mua, të qëndroj larg prej gjithë asaj që është e gabuar. Është kaq e vështirë për mua dhe unë jam kaq i dobët, por Ti je më i Fuqishëm!

Thënje e urtë: Forca e mendimit hyn në punë më shumë se tehu i shpatës; prandaj ruaje atë dhe mbaje gati për ta përdorur në kohën e duhur.

Dita 10

Ajet Kuranor:“ ...All-llahu i do ata që pendohen dhe ata që ruhen prej punëve të ndyta e të neveritshme.“ (El-Bekare: 222).

Hadith profetik: “Me të vërtetë në trup ka një copë mishi, nëse ajo përmirësohet, i gjithë trupi është mirë, por nëse ajo është e prishur, atëherë i gjithë trupi është i prishur. Kjo copë mishi është zemra.”

Duaja e ditës: Ja Allah! Më mundëso mua të të dua, ashtu siç Ti e meriton të duhesh, më mundëso të frikësohem nga Ty, ashtu siç Ti e meriton të të frikësohem dhe më mundëso t’i shërbej krijesave të Tua të kësaj bote për hir Tënd!

Thënje e urtë: Gjithmonë rikujtoi tri gjëra: Të duash, të sakrifikosh dhe të falësh.

Ki kujdes nga tri të tjera: Të tradhtosh, të mashtrosh dhe të lëndosh.

Mos jeto me tre njerëz: Tradhtarin, injorantin dhe mendjemadhin.

Njerëzve dhuroja tri gjëra: Dashurinë, fjalën e mirë dhe korrektësinë.

Dhe kur e donë një njeri, hulumtoi në të tri gjëra: Singëritetin, ndershmërinë dhe besnikërinë.

Dita 11

Ajet Kuranor:“ ...të silleni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve dhe njerëzve u thuani fjalë të mira; Faleni namazin dhe jepni zeqatin...”(El-Bekare: 83)

Hadith profetik: “Nuk ka gjë që e rëndon peshoren e punëve të mira ditën e Kiametit, më shumë se morali i mirë. Zoti e urren një gjuhë banale dhe të ulët.”

Duaja e ditës: O Allah! Ma shto dijen, por ma mundëso që kjo dije të jetë me sinqeritet, jo për kërkimin e famës dhe lavdisë, pozitës apo pasurisë materiale. Mundësoje që kjo dije të shërbejë në rrugën Tënde, në atë mënyrë që Ti e pranon dhe mundëso prej saj, që njerëzimi të ketë dobi.

Thënje e urtë: Dy gjëra do më ndjekin pas gjithë jetën: Shikimi i Zotit dhe zemra e Nënës.

Njeriu nuk është i përjetshëm, le të përpiqet të jetë e pavdekshme ajo që do të thotë dhe ajo që do të bëjë. Katastrofat duhen pritur kur mëkatarët bëhen prijës, prijësat bëhen shërbëtorë dhe gjynahqarët respektohen.

Mendja e një kombi është arsimi, zemra e tij është morali i përgjithshëm.

Dita 12

Ajet Kuranor: “Pra ju më kujtoni Mua (me adhurime), Unë ju kujtoj juve (me shprëblim). Më falënderoni e mos Më mohoni.”(El-Bekareh: 152).

Hadith profetik: “Kur të lutesh për diçka lutju Zotit, kur të kërkosh ndihmë, kërkoi Zotit e ta dish, se e gjithë dynjaja po të mblidhet për të të bërë një të mirë, nuk do ta bëjnë, nëse nuk ka qenë kader nga Zoti dhe po u mblodh e gjithë bota për të të bërë një të keqe, nuk do të munden ta bëjnë, nëse nuk ka qenë kader nga Zoti. Janë ngritur lapsat dhe janë tharë fletët”.

Duaja e ditës: O Allah! Udhëzoi fëmijët e mi dhe gjithë fëmijët e muslimanëve. Ata janë të rrethuar nga kaq shumë joshje dhe haramë . Mbroji ata prej gjithë ndikimeve të këqija, që i rrethojnë. Jepu atyre shokë, të cilët do të forcojnë besimin e tyre dhe ndihmoji ata, që të qëndrojnë në Rrugën e drejtë!

Thënje e urtë: Përmendja e Allahut është jetë për shpirtin dhe shpirt për jetën, është prehje për trupin, qetësi për zemrën dhe rahat për mendjen. Dhikri është ritual të cilin Zotin e ka ligjëruar për lumturinë tonë.

Dita 13

Ajet Kuranor: „Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin (fenë dhe Kur'anin) e All-llahut, e mos u përçani! Përkujtojeni mirësinë e All-llahut ndaj jush, kur ju (para se ta pranoni fenë islame) ishit të armiqësuar, e Ai i bashkoi zemrat tuaja dhe ashtu me dhuntinë e Tij aguat të jeni vëllezër.“(Ali-Imran: 103).

Hadith profetik: "Shembulli i besimtarëve në miqësinë, solidaritetin, dashurinë dhe mëshirën mes tyre, është si shembulli i trupit, një gjymtyrë po të lëndojë, i gjithë trupi vuan nga pagjumësia dhe ethet."

Duaja e ditës: “O Zot më ruaj nga halli dhe mërzia, nga paaftësia dhe përtacia, më ruaj nga frika dhe kopracia, më ruaj që të mos më mundin borxhet e të më shkelin njerëzit me këmbë!”

O Allah në këtë ditë, mi hap dyert e parajsës dhe mbylli dyert e skëterrës, më ndihmo të recitoj Kur'anin, o Zbritësi i qetësisë në zemrat e besimtarëve!

Thënje e urtë: Sikurse ndërtimi i shtëpisë nis nga themelet, e jo nga çatia, ashtu dhe ndryshimi vjen nga vetja, e pastaj nga shoqëria.

Dita 14

Ajet Kuranor: „Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit.“
(Ali-Imran: 104).

Hadith profetik: “Kush thërret për në rrugën e drejtë, ka të njëjtin shpërblim, si shpërblimi i atyre, që e ndjekin atë dhe nuk i pakësohet aspak nga shpërblimi i tyre. Ndërsa kush thërret për në rrugë të shtrembër ka të njëjtin gjynah, si gjynahu i atyre, që e ndjekin duke mos pakësuar aspak nga gjynahu i tyre.”

Duaja e ditës: O Allah! Udhëzoi dhe mbroji adoleshentët tanë, të cilët kanë nevojë për ndihmën dhe udhëzimin Tënd nga çdo joshje e prostitucionit, drogës, alkoolit dhe gjithë haramëve të tjera të shoqërisë sonë! O Allah në këtë ditë më zbukuro me sinqeritet dhe ndershmëri, më mbulo me rrobën e endjes dhe të pastërtisë!

Thënje e urtë: Një dhimbje e vërtetë nuk është kur rrjedhin lotët nga faqet e tua, por kur i mban lotët brenda me buzëqeshjen në fytyrë, duke i fshirë lotët dikujt tjetër.

Dita 15

Ajet Kuranor:“Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në Allahun.”(Ali-Imran: 110).

Hadith profetik: “Allahu nuk ua heq diturinë njerëzve në mënyrë të menjëhershme, por ua heq atë me heqjen e dijetarëve. Atëherë kur të mos ketë ngelur asnjë dijetar, njerëzit do të marrin për të parë injorantët. Kur të pyeten, do të japin përgjigje pa kurrfarë dije. Ata kanë humbur vetvetet dhe po ashtu do t'i çojnë të tjerët në humbje”.

Duaja e ditës: O Allah! Më udhëzo mua, që të kërkoj dituri nga Ty dhe bekoje këtë besim (fe) nga ata që janë të sinqertë, të cilët zotërojnë dijen e saktë islame, të cilët janë të mesëm dhe të butë, të cilët nuk janë të ashpër apo të paduruar me mua dhe të cilët e kuptojë nga ku po vij unë, gjendjen time si mysliman në këtë vend, duke jetuar në këtë botë sot!

Thënje e urtë: Nëse do që të njohësh pozitën tënde tek Allahu shihe se me çfarë të ka preokupuar.

Dita 16

Ajet Kuranor: „Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.“(En-Nahl: 97).

Hadith kudsij: “Vërtet All-llahu i ka përcaktuar cilat janë veprat e mira e cilat të këqija, pastaj i ka sqaruar ato: Kush dëshiron me zemër të bëjë një vepër të mirë, por nuk mund ta kryejë, All-llahu do t’ia shkruajë atë vepër si të kryer të plotë, kurse nëse dëshiron të bëjë një vepër të mirë dhe e kryen, All-llahu do t’ia shkruajë dhjetë deri në shtatëqind herë më tepër. Por nëse dëshiron të bëjë ndonjë vepër të keqe e nuk e kryen, All-llahu do t’i shkruajë një vepër të mirë të plotë, kurse nëse dëshiron dhe kryen një vepër të keqe, atëherë All-llahu ia shënon vetëm një vepër të keqe”.

Duaja e ditës: O Allah! Na përdor gjithmonë në rrugën e drejtë dhe për veprat e hajrit!

Thënje e urtë: Janë dy grupe nga ummeti im që, kur ata janë të devotshëm, ummeti im do të jetë në të drejtë e kur ata janë të prishur ummeti im do të korruptohet: dijetarët dhe sundimtarët.

Dita 17

Ajet Kuranor: „Ja, ju jeni ata që ftoheni për të dhënë në rrugën e All-llahut, e dikush prej jush bën koprraci, e kush bën koprraci, ai bën kundër vetvetes, All-llahu s’ka farë nevoje, e ju jeni të varfër (keni nevojë). Po nëse ju i ktheni shpinën, Ai do t’ju zëvendësojë me një popull tjetër, që nuk do të jetë si ju.“ (Muhammed:38).

Hadith profetik: “Allahu më ka shpallur mua, që t’u urdhëroj që të jeni modestë me njëri-tjetrit, askush prej jush mos të jetë mburravec ndaj tjetrit e askush të mos i ofendojë të tjerët”

Duaja e ditës: O Allah! Më jep mua aftësinë për të falur të gjithë ata, që më kanë lënduar në këtë botë dhe në besim, veçanërisht vëllain tim..., i cila ka injoruar çdo përpjekje time që kam bërë, për tu pajtuar me të. Të lutem O Allah, bashkoji zemrat tona! O Allah në këtë ditë më bëj t’i mëshiroj jetimët, t’i ushqej të uriturit, të përhap selamin dhe të qëndroj me të mencurit, o Strehues i shpresuesve!

Thënje e urtë: Një provë që të sjellë më afër Zotit është më e mirë se një begati që të bën ta harrosh Atë. Asgjë nuk është më e shtrenjtë se sa ajo që blihet me lutje.

Dita 18

Ajet Kuranor:“O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni! Kini frikë nga ndëshkimi i All-llahut, e All-llahu është mëshirues, Ai pranon shumë pendimin.”(El-Huxhurat: 12).

Hadith profetik: “Allahu është i bukur dhe e do të bukurën. Mendjemadhësia është refuzimi i të vërtetës dhe sjellja me arrogancë ndaj njerëzve”.

Duaja e ditës: O Allah! Ti je Zoti im, nuk ka të adhuruar tjetër me meritë përveç Teje, Ti më ke krijuar dhe unë jam robi Yt, do të qëndroj besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit Tënd, sa të kem mundësi, kërkoj mbrojtjen Tënde nga e keqja që kam vepruar, unë jam mirënjohës ndaj dhuntive të Tua, i pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal mua, pasi mëkatet nuk mund t'i fal askush përveç Teje!

Thënje e urtë: Nëse kërkon të gjesh një vend ku të gjithë janë të barabartë, shko te varrezat.

Dita 19

Ajet Kuranor: „E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtare, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me një mëkat shumë të madh. „ (El-Ahzab: 58).

Hadith profetik: “Njeriu më i dashur tek Allahu është më dobiprurësi, puna më e mirë tek Allahu xh.sh është t’i fusësh gëzim myslimanit, ose t’i mënjanoj atij një brengë (vuajtje), ose t’ia likuidosh borxhin, ose t’ia largosh urinë. Personit që e përmban zemërimin, Allahu ka për t’ia mbuluar intimitetin (auretin) e tij, personit që e përmban mllëfin të cilin është i mundur ta çlirojë po deshi, atij Allahu Ditën e Gjykimit ia mbushë zemrën me gëzim. Kush ecë me vëllain e tij mysliman pas nevojës që ai ka, derisa t’ia konsolidojë (përmbushë) atë, atij Allahu i Lartësuar ka për t’ia përforcuar këmbët në ditën kur këmbët rrëshqasin. E morali i keq i prish punët siç e prish uthulla mjaltin.”

Dua e ditës: O Allah! Më forco në rrugën Tënde, më bëj të jetoj dhe të vdes në rrugën Tënde!

Thënje e urtë: Fjala e keqdashësit është si qymyri; edhe kur nuk djeg sendin që prek, e nxin atë.

Dita 20

Ajet Kuranor: „E robërit e Zotit janë ata që ecin nëpër tokë të qetë, e kur atyre me fjalë u drejtohen injorantët, ata thonë: “Paqe!” (El-Furkan: 63).

Hadith profetik: “Kur biri i Ademit vdes, nuk ka më punë që të gjykohet, përveç tre punëve: sadakaja e rrjedhshme, dija e dobishme, që ka lënë pas dhe fëmija i mbarë, që lutet për të”

Duaja e ditës: O Allah! Pastroje zemrën time nga sëmundja e arrogancës dhe krenarisë dhe më lër mua të vdes si mysliman i sigurtë, i thjeshtë! O Allah në këtë ditë, pastromë nga papastërtia e ndyrësia, më bëj durimtar ndaj asaj që është shkurtuar, jepmë aftësinë të bëhem i devotshëm, e të shoqërohem me të mirët, me ndihmën Tënde, o i dashuri i të skamurve!

Thënje e urtë: Gjerdani më i çmuar që do kesh rreth qafës, janë krahët e fëmijës tënd.

Peshën e gabimeve e kupton vetëm atëherë kur përballësh me njerëz që nuk falin.

Të shtiresh i gëzuar kur je i mërziur, është njësoj sikur të dalësh në shi dhe të thuash nuk jam lagur.

Punën e sotme mos e lër për nesër.

Goja kapak ,trupi rahat.

Dita 21

Ajet Kuranor: „Nuk është e barabartë e mira dhe e keqja. Andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë, se atëherë ai, me të cilin kishit njëfarë armiqësie, do të bëhet mik i afërt.“ (Fussilet: 34).

Hadith profetik: “Një njeri thotë një fjalë që e kënaq Allahun pa i kushtuar rëndësi, ajo fjalë bëhet shkak që Allahu ta fusë në xhenet. Por një njeri thotë një fjalë që e zemëron Allahun pa i kushtuar rëndësi, bëhet shkak ajo fjalë që ai të hidhet në zjarrin e xhehenemit.”

Duaja e ditës: O Allah! Hap një rrugë për mua, në mënyrë që ta bëj Haxhin sa më shpejt të jetë e mundur, dhe kështu të përmbush obligimin tim tek Ty dhe të fitoj kënaqësinë Tënde dhe xhenetin Tënd!

Thënje e urtë: Njeriu kur ndjen dhimbje, është i gjallë.. Por kur ndjen dhimbjen e tjetrit, atëherë është NJERI. Fytyrën e njerëzve e sheh në dritë, kurse karakterin në errësi.

Nuk kam parë që dikush të ketë mirësi më të madhe se femra, e fut në xhenet babain e saj sa është fëmijë, e plotëson gjysmën e fesë së burrit të saj sa është në rini, ndërsa nën këmbët e saj qëndron xheneti sa është nënë në pleqëri.

Dita 22

Ajet Kuranor: „Kush bën ndonjë të keqe ose e ngarkon veten, pastaj kërkon falje te All-llahu, ai e gjen All-llahun falës dhe mëshirues.“ (En-Nisa: 110).

Hadith profetik: “Me të vërtetë Allahu i Lartësuar e shtrin dorën natën që të pendohet ai që ka mëkatuar gjatë ditës. Po ashtu Ai e shtrin dorën e Tij ditën, që të pendohet ai që ka mëkatuar gjatë natës. Kjo ndodh derisa dielli të lindë nga perëndimi.”

Duaja e ditës: O Allah! Bekoji vëllezërit e mi, të cilët janë të gjindshëm gjithmonë në xhamitë tona për të riparuar, për të pastruar apo për të mësuar në to!
O Allah në këtë ditë, ma trego rrugën për të fituar kënaqësinë Tënde, mos ia mundëso shejtanit të më mposhtë, bëje Xhenetin vendqëndrim dhe prehje për mua, o Dëgjues i lutjeve të nevojtarëve!

O Allah në këtë ditë, mi hap dyert e mirësisë Tënde, zbritmi bekimet e saj, ndihmomë drejt shkaktuesve të mëshirës Tënde, e më jep një vend në rehatinë e Parajsës, o Dëgjuesi i thirrjes së të pikëlluarit!

Thënje e urtë: Një burrë i mirë është shpëtimi i gruas, një grua e mirë është shpëtimi i familjes.

Dita 23

Ajet Kuranor: „O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt dhe hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar.“ (El-Maideh: 90)

Hadith profetik: “I gjithë populli im është i falur përveç atyre që publikojnë gjynahet. Prej publikimit, është se njeriu natën vepron një mëkat, pastaj kur gdhin pasi Allahu i ka fshehur atë, ai thotë: O filan, mbrëmë kam vepruar kështu e ashtu. Atë e zuri gjumi dhe Allahu ia fshehu gjynahin, por në mëngjes ai e zbuloi atë që Allahu e fshehu.”

Duaja e ditës: O Allah! Largoje perden në sytë e atyre, që kanë qenë të mashtruar duke e parë Islamin si diçka të keqe, për shkak të paditurisë dhe stereotipave mediatikë!

Thënje e urtë: Dija është më e mirë se pasuria. Dija është një mbrojtje për ty, ndërsa je ti ai që duhet ta mbrosh pasurinë. Zekati i dijes është vepra, ndërkohë që dituria shtohet me shpërndarjen e saj ndërsa harxhimi e pakëson pasurinë. Dashuria ndaj dijetarit është pjesë e fesë.

Dita 24

Ajet Kuranor:“Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?” (El-Maideh: 91).

Hadith profetik: “Nuk ka smirë tjetër, përveç smirës ndaj dy personave. Njërit Allahu i ka dhënë Kur’anin e ai i jep hakun ditën dhe natën dhe një personi tjetër, që Allahu i ka dhënë para e ai e shpenzon në rrugë të Allahut ditën dhe natën”.

Duaja e ditës: O Allah! Afroji gjithë njerëzit pranë Teje dhe pranë njëri-tjetrit! Të lutem mos na bëj ne myslimanëve sprovë për ata, me keq prezantimin tonë të Islamit si pasojë e sjelljes sonë të keqe! O Zot! Më jep aq mend ta kuptoj sa i pamend jam, më jep aq dije ta kuptoj sa i padijshëm jam, më jep aq forcë ta kuptoj sa i pafuqishëm jam, e kur ngadhnej mbi tokë, më bëj të mos harroj se prapë do të bëhem tokë!

Thënje e urtë: Shenjat e ndershmërisë janë katër: besnikëria, besimi në premtimin dhe ndëshkimin Hyjnor, mbajtja e fjalës dhe shmangia e hiles.

Dita 25

Ajet Kuranor: „All-llahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.“ (En-Nahl: 90).

Hadith profetik: “Kush gdhin i qetë në vatrën e tij, i shëndoshë në trup dhe ka të garantuar rrizkun e ditës, është tamam sikur ka poseduar të tërë dynjanë.

Duaja e ditës: O Zot! Nëse unë të harroj Ty, mos më harro Ti mua! O Zot, më ndihmo ta them fjalën e vërtetë para të fuqishmëve dhe më ndihmo që të mos e them të pavërtetën për t’i fituar duartrokitjet e të dobëtëve! O Zot, nëse më jep pasuri, mos ma merr lumturinë, e nëse më jep fuqi, mos ma merr mendjen! O Zot, kur të më dhurosh sukses, mos ma merr lumturinë time, e kur të më dhurosh modesti, mos ma merr krenarinë me karakterin tim! O Zot, më mëso se toleranca është niveli më i lartë i forcës, kurse dëshira për hakmarrje është aspekti i parë i dobësisë!

Thënje e urtë: Shkalla më e lartë e sinqeritetit është përpjekja për të fshehur adhurimet ashtu siç i fsheh gabimet.

Dita 26

Ajet Kuranor:“ S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni pajtim ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kini frikë Allahun, që të jeni të mëshiruar (nga Zoti). „ (El-Huxhurat: 10).

Hadith profetik: “Çështja e besimtarit është e habitshme. Në fakt e gjithë çështja e tij është mirësi. Kjo i ndodh vetëm besimtarit. Nëse i vjen një e mirë, ai falenderon dhe kjo është mirë për të. Nëse e godet një e keqe, ai duron dhe kështu është mirë për të”

Duaja e ditës: O Allah! Në këtë ditë, dhuromi bekimet e Natës së Kadrit, ndryshomi punët nga të vështira në të lehta, ma prano pendimin nga mëkatet e bëra, o i Mëshirshmi ndaj krijesave të veta! O Zot, Ti je falës e don faljen prandaj më fal mua! O Zot, më mëso t’i dua njerëzit ashtu siç e dua veten dhe më mëso ta gjykoj veten ashtu siç i gjykoj njerëzit! O Zot, mos lejo të prekem me arrogancë kur kam sukses dhe mos lejo të prekem me pesimizëm kur dështoj, por më përkujto gjithherë se dështimi është përvojë që i paraprinë suksesit!

Thënje e urtë: Buzëqeshja është fjalë e ëmbël pa shkronja.

Dita 27

Ajet Kuranor: „Ne e zbritëm atë (Kur'anin) në Natën e Kadrit. E ç'të bëri ty të dish se ç'është Nata e Kadrit? Nata e Kadrit është më e rëndësishme se një mijë muaj! Me lejen e Zotit të tyre në (atë natë) të zbresin engjëjt dhe shpirti (Xhibrili) për secilën çështje. Ajo (që përcakton Zoti) është paqe deri në agim të mëngjesit.“
Sure al Kadr

Hadith profetik: “Kush e kalon me namaz Natën e Kadrit me besim tek premtimi i Allahut dhe shpresë tek Ai, i falen mëkatet që ka bërë më parë.” “Kërkojeni natën e Kadrit në netët tek të dhjetë ditëve të fundit të Ramazanit.”

Duaja e ditës: Zoti im! Ti je Falës, Bujar, e do faljen, ndaj më fal mua! O Zot, nëse më zhvesh nga pasuria, ma lë shpresën, nëse më zhvesh nga suksesi ma lë fuqinë e këmbënguljes derisa të triumfoj kundër dështimit, e nëse më zhvesh nga shëndeti, ma lë dhuntinë e besimit! O Zot, nëse bëj keq ndaj njerëzve, më jep forcën e kërkimfaljes, e nëse ndaj meje bëjnë keq njerëzit, më jep forcën e faljes dhe tolerancës!

Thënje e urtë: Kush ikën prej vdekjes, prej tij ikën jeta.

Dita 28

Ajet Kuranor:“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se te Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e All-llahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”(El-Huxhurat: 13).

Hadith profetik: “Kush i ka tre cilësi, ka gjetur ëmbëlsinë e besimit. Allahu dhe i dërguari i Tij të jenë tek ai më të dashur se çdo gjë tjetër. Ta dojë një person vetëm për hir të Allahut. Të urrejë të kthehet në mosbesim (kufr), pasi Allahu e shpëtoi, ashtu siç urren të hidhet në zjarr”.

Duaja e ditës: O Allahu im! Ti i ndëgjon lutjet e mia, të lutem o Allah më prano namazet dhe mos më ndaj prej tyre, O Allah ma mundëso që çdo namaz ta fali në kohën e vet e asnjëherë të mos më vijë puna të mos kem mundësi ta fali, dhe më bëj prej atyre që veprojnë me vepra sipas fjalës.

Thënje e urtë: Bëhuni si pema të cilën njerëzit e gjuajnë me gurë ndërsa ajo ju lëshon fruta.

Dita 29

Ajet Kuranor:“ Besimtarë janë vetëm ata që i besuan All-llahut, të dërguarit e Tij, e mandej nuk dyshuan dhe për hir të All-llahut luftuan me pasurinë dhe me jetën e tyre. Të tillë janë ata të vërtetit.” (El-Huxhurat: 15)

Hadith profetik: “Shejtani lidh tre nyje pas kokës kur ndonjëri prej jush bie në gjumë. Për çdo nyje troket dhe thotë: ke një natë të gjatë, prandaj fli. Nëse zgjohesh dhe e përmend Allahun, zgjidhet një nyje. Nëse merr abdes, zgjidhet nyja e dytë e nëse falesh zgjidhet nyja e tretë. Nëse vepron kështu gdhin i lumtur dhe i disponueshëm, në të kundërt gdhin i padisponueshëm dhe përtac.”

Duaja e ditës: O Allah! Pranoi namazet e mia, pranoi lutjet e mia, pranoi veprat e mira dhe më largo prej gjynaheve më mbroj nga to, më largo nga përgojimi dhe mos më bëj prej banorëve të zjarrit!

Thënje e urtë: 'Nuk është i madh ai njeri i cili nëse ulesh pran tij të bënë të ndihesh i vogël por i madh është ai njeri i cili nëse ulesh pran tij ndihesh edhe ti i madh”.

Dita 30

Ajet Kuranor:“O ju që keni besuar, a t’ju tregoj për një tregti të bujshme që ju shpëton prej një dënimi të Dhembshëm? T’i besoni All-llahut dhe të dërguarit të Tij, të luftoni në rrugën e All-llahut me pasurinë tuaj dhe veten tuaj, e kjo është shumë më e dobishme për ju, nëse jeni që e dini.” (Es-Saff: 10-11).

Hadith profetik: “Dynjaja është e ëmbël dhe e gjelbër. Allahu ju ka bërë zëvendës në të, që t’ju shikojë se si do të veproni. Kini frikë dynjanë dhe gratë, sepse sprova e parë e bijve të Israelit ka qenë sprova e grave”.

Duaja e ditës: O Zoti ynë Bujar! Të lutemi nga thellësia e zemrës të na e kesh pranuar agjërimin dhe çdo vepër tonën dhe të kërkojmë falje për çdo mangësi e gabim! Ndhimën Tënde kërkojmë që të përkushtohemi ndaj Teje në 11 muajt në vijim dhe Ty të lutemi që e gjithë jeta jonë të jetë Ramazan dhe ndarja nga kjo botë të jetë për ne Bajram!

Thënje e urtë: "Lumturia nuk është në pasuri, në forcë apo pushtet por lumturia qëndron në atë se çfarë bën me pasurinë, forcën dhe pushtetin".

Testoni njohuritë e juaja rreth Ramazanit.

1-Cilat janë kushtet e islamit?

2-Sa Ramazane ka agjëruar Muhamedi a.s?

3-I sati muaj është Ramazani sipas kalendarit islamik?

4-Muhamedi a.s ka thënë: „Agjëruesi ka dy gëzime.....“ cilat janë ato dy gëzime të agjëruesit?

5-Si e ka emrin dera e Xhennetit, nga e cila do të futen vetëm agjëruesit?

6-Cila është mrekullia më e madhe e Pejgamberit Muhammed a.s?

7-Përmend 5 kohë kur pranohet duaaja.

8-Çfarë shpërblimi ka ai person që agjëron ditën e Arafatit?

9-Në cilat faqe të Kuranit ndodhen ajetet e agjërimit?

10-Përmend 5 agjërime nafile.

11-Cila është lufta e parë që kanë bërë muslimanët në kohën e Muhammedit a.s dhe kur ka ndodhur?

12-Cili është ai farz që nuk ka as kohë dhe as numër të caktuar?

13-Në cilën ditë (natë) zbriti Kur’ani Famëlartë?

14-Si quhet sadakaja që duhet të japë besimtari në fund të Ramazanit?

15-Përmend 3 gjëra që e prishin agjërimin.

16-Cili është muaji më i mirë i vitit dhe përse?

17-Cfarë do të thotë fjala agjërimit?

18-Si ishte agjërimi i Davudit a.s?

19-Përmend 5 mirësi të agjërimit.

20-Sa ditë ka muaji i Ramazanit?

21-Çfarë duhet të bëjë ai që e prish me dashje një ditë agjërimit në muajin e Ramazanit?

22-Si është duaja e iftarit?

23-Sa ajete Kurani lexonte Pejgamberi a.s nga imsaku deri në namazin e Sabahut?

24-Përse është bekuar muaji i Ramazanit?

25-Cili është qëllimi i agjërimit në Ramazan?

26-Kur është nata e Kadrit?

27-Cila është duaja që bënte Pejgamberi a.s më shpesh?

28-Cila është duaja e natës së Kadrit?

29-Si e kompenson agjërimitin ai që nuk agjëron dot nga sëmundja kronike?

30-Çfarë janë ato dy gjëra (vepra të mira) që do të ndërmjetësojnë ditën e gjykimit për atë person që i ka kryer në dunja?

Përgjigjet:

1. Kushtet e islamit janë: Shehadeti apo dëshmia, falja e namazeve, agjërimi i muajit të shenjtë të Ramazanit, dhënja e zeqatit dhe kryerja e haxhit.
2. Muhamedi a.s ka agjëruar 9 Ramazane.
3. Ramazani është muaji i 9 sipas kalendarit islamik.
4. “Agjëruesi ka dy gëzime; kur hap iftarin dhe kur do të takohet me Allahun xh.sh.”
5. Rejjan quhet dera e xhenetit prej të cilës do të futen vetëm agjëruesit.
6. Kurani i madhërueshëm është mrekullia më e madhe e Pejgamberit Muhamed a.s.
7. Kohët kur pranohet duaja: Para iftarit, mes ezanit dhe ikametit, kur bien shi, një orë ditën e xhuma, ditën e arafatit dhe pjesën e fundit të natës.
8. Ai që agjëron ditën e Arafatit i falen gjynahet e vitit të kaluar dhe të ardhshëm.
9. Ajetet e agjërimit gjenden në faqen e 29 dhe 30 të Kuranit Famëlartë.
10. Agjërimi i ditës së hënë dhe të enjte, agjërimi i ditës së Arafatit, ditës së Ashures, 6 ditët e muajit sheval, 9 ditët e para të muajit dhilhixhe.
11. Lufta e parë quhet lufta e Bedrit e cila është bërë ditën e 17 të ramazanit.

12. Dhikri apo përmendja e Zotit është i vetmi farz-obligim që nuk ka as kohë e as numër të caktuar. "O ju që keni besuar, përmendeni Allahun sa më shpesh." Sure Ahzab /41
13. Kurani famëlartë ka zbritur natën e Kadrit. Sure Kadr /1
14. Sadakaja që duhet të japë besimtari në fund të Ramazanit quhet Sadakatul-Fitr.
15. Agjërimin e prishin gjërat e mëposhtme: Ngrënja dhe pirja me qëllin, marrëdhëniet intime, vjellja me qëllim.
16. Muaji më i mirë i vitit është muaji i Madhërueshëm i Ramazanit pasi në të ndodhet nata e bekuar e Kadrit.
17. Agjërim do të thotë abstenim apo largim nga ngrënja, pirja dhe marrëdhëniet intime nga mëngjesi deri në aksham.
18. Agjërimi i Davudit a.s ishte se ai një ditë agjëronte e një ditë jo.
19. Mirësitë e agjërimit: Mbrojtje nga zjarri i xhehenemit, shëndet, mëshirë, falje dhe agjëruesi futet në xhenet nga dera Rejjan.
20. Muaji i Ramazanit ka 29 ose 30 ditë.
21. Pendim të singertë tek Allahu dhe kompensim me agjërim 61 ditë pa ndërprerë.

22. Duaja e iftarit: O Allah, për Ty agjëroj, Ty të besoj, në Ty mbështetem dhe me begatitë e Tua po bëj iftar. Kaloi etja, u lagën venat dhe u realizua shpërblimi InshaAllah!
23. Pejgamberi a.s lexonte rreth 50 ajete Kurani nga imsaku deri në namazin e sabahut.
24. Muaji i Ramazanit është bekuar pasi në të gjendet nata e madhe e Kadrit në të cilën zbriti Kurani Famëlartë.
25. Qëllimi i agjërimit është shtimi i devotshmërisë. Sure Bekake /183

26. Nata e Kadrit është në një nga netët teke në dhjetë ditëshin e fundit të Ramazanit.
27. Duaja që bënte më shpesh Pejgamberi ynë ishte: O Allah, o rrotullues i zemrave, forcoje zemrën time në rrugën Tënde!
28. Duaja e natës së Kadrit: O Allah, Ti je falës, e don faljen, na fal neve!
29. Kompesimi i agjërimit bëhet me ushqimin ditor të ndonjë të varfëri për çdo ditë që nuk e ka agjëruar dot.
30. Agjërimi dhe Kurani do të ndërmjetësojnë për pronarët e tyre ditën e Kijametit.

„Agjëroni që të jeni të shëndetshëm.“

Agjërimi është operim pa bisturi.

Agjërimi korr sukses aty ku mjekësia
dështon.